

Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.

Raport paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

**“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie
Kraja”- “Kokonozet”- “Zana Floqi”- “Filip Shiroka”,
Tirane.**

ZHVILLUES: BASHKIA TIRANE

Ligji nr. 10440 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”, i
ndryshuar, Shtojca II, pika 10/b

PASQYRA E LENDES

1. HYRJA

1.1 PERSHKRIMI I PROJEKTIT

1.2 KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

2. PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES KU PROPOZOHET TE ZBATOHET PROJEKTI

3. INFORMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE, NE SIPERFAQEN E KERKUAR NGA PROJEKTI DHE NE AFERSI TE TIJ

4. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TE MUNDSHME, NEGATIVE, NE MJEDIS, TE PROJEKTIT

5. PERSHKRIMI PER SHKARKIMET E MUNDSHME NE MJEDIS

6. TE DHENA PER SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPESINORE TE NDIKIMIT NEGATIV NE MJEDIS

7. MASAT E MUNDSHME PER SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS;

8. NDIKIMET E MUNDSHME NE MJEDISIN NDERKUFITAR (NESE PROJEKTI KA NATYRE TE TILLE).

9. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

1. HYRJA

1.1 PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Ky vleresim i ndikimit ne mjedis do te paraqese nje informacion te shkurter te projektit qe do te realizohet, ndikimet pozitive dhe negative ne mjedis dhe masat qe investitori do te marre per zbatimin e kriterëve te nevojshme per mbrotjen dhe menaxhimin sa me racional te mjedisit.

Theksojme se shume nga vleresimet e detajuara te ndikimeve te mjedisit mbeshteten ne informacionet inxhinierike qe duhet te merren parasysh. Vleresimi identifikon ne menyre te qarte si perfitimet pozitive edhe negative dhe percakton "rezultate te pergjithshme" per secilen prej tyre. Vleresimi identifikon nese ndikimet jane mesatare te pranueshme, te rendesishme, te terthorte apo te drejtperdrejta.

Objekti i kesaj hyrje - permbledhje per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis te ndertimit te objektit ne studim:

- Te minimizojë streset ne mjedis dhe ne radhe te pare ne elementet prioritare si ruajtja e tokes, kontrolli i zhurmave, dhe ruajtja e cilesise se ujit dhe ajrit;
- Te ruaje ose rehabilitoje mjedisin natyror permes elementeve te reja te nderhyrjes pozitive, punimeve te vecanta ne kuader te projektit ose paralel me te, te cilet sigurojne vijueshmerine e qendrueshme te mjedist biologjik duke perfshire faunen dhe floren ne mjediset perreth zones se marre ne konsiderate.

Hyrje

Rrethi i Tiranes, shtrihet ne Shqiperine e mesme, pjeserisht ne krahinen malore qendrore dhe pjeserisht ne ultesiren perendimore. Siperfaqja eshte 1238 km². Popullsia rreth 900.000 banore. Ne te perfshihen 150 fshatra. Dendesia mesatare 655.3 banore per km². Popullsia qytetare 86.2%, popullsia fshatare 13.8%. Rritja natyrore 1.54%. Mbizoteron relievi malor kodrinor. Lartesia mesatare eshte 521 m mbi nivelin e detit. Male kryesore: Martaneshi (1846 m), Mali me Gropa (1828 m), Mali i Dajtit (1612 m). Kodrat: e Prezes, e Pezes, e Kerrabes, Kodra e gjate. Fushat shtrihen ne veri e veriperendim: Fusha e Tiranes, fusha e Vores, fusha e Yzberishit. Lumenjte: Erzeni i siperm dhe i mesem, lumi i Tiranes, lumi i Terkuzes, perroi i Lanes, perroi i Limuthit. Klima eshte e bute, ne pjesen perendimore fushore e kodrinore, ashpersohet ne lindje, ku jane malet. Temperatura mesatare vjetore ne Tirane 15°C.

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

Temperatura mesatare e janarit 6.8°C, e korrikut 23.5°C, temperatura absolute me e ulet ne Tirane -9.9°C, me e larta absolute 41.3°C. Reshjet mesatare vjetore 1247 mm. Ererat zoteruese veriperendim dhe juglindje. Ne vere ndihet ndikimi freskues i puhise detare. Pasurite minerale: qymyrguri (Kerrabe, Mushqeta, Mezez, Valias, Priske), bokside (Priske,Dajt), gips, rere kuarcore (Mezez, mermer, argjile, gure gelqeror. Tokat bujqesore: te hinjta kafe (82.8%), aluvionale (12.3%) etj. Pyjet dhe shkurret zene 41% te siperfaqes, kullotat 5.65. Parku kombetar i Dajtit perfshin 3000 ha. Burimet ujore nentokesore kryesore: te Selites, Shemrise, Gurres se Koçit, Gurres se Maliqit, Gurres se Shametes.

Qyteti i Tiranës gjate viteve te fundit ka pesuar nje rritje te ndjeshme te popullsisë si dhe nje zhvillim te pergjithshem me ritme teper te larta. Tashme Tirana eshte kthyer ne nje metropol. Ky zhvillim dhe rritja e konsiderueshme si e automjeteve te qytetit te Tiranës, ashtu edhe levizja teper intensive e trafikut si me qytetet e tjera ashtu edhe me shtetet fqinje, kerkojne nje sistem rrugor te zhvilluar.

Aktulisht akset kryesore te qytetit te Tiranës jane rikonstruktuar apo zgjeruar. Nderkohe qe ndihet nevoja e hapjes se rrugeve dhe koridoreve te reja te levizjes.

Per sa me siper Bashkia e Tiranës, ne rolin e Autoritetit Kontraktor ka lidhur kontrate me konsulentin JV “STUDIO - REBUS” shpk & HIDROWATER-ALBANIA shpk, per te realizuar projektin e zbatimit (studim projektimin) e objektit: “Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”- “Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Njesia administrative Nr.3 ne qytetin e Tiranës.

Te dhena dhe kerkesa te pergjithshme

Ne zonen ku do te ndertohet objekti “Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”- “Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Njesia administrative Nr.3 ne qytetin e Tiranës , gjate hartimit te projektit te rrugeve, te mbahen parasysh Studimet Urbanistike Pjesore, parashikimet e Planit te Ri Rregullues dhe Masterplani i Trasportit. Gjithashtu, per te percaktuar sakte kapacitetin per te gjitha sherbimet e kerkuara, duhet patur parasysh koeficienti i dendesise se popullsisë, sipas Rregullores se Urbanistikes (KTP) ne fuqi ose 400 banore/ha, si dhe duhen marre ne konsiderate zhvillimet urbane te pritshme dhe ne perspektive te zones/bllokut ne fjale. Blloku kufizohet nga rruget “Marie Kraja”, “Kokonozet”, “Zana Floqi” dhe “Filip Shiroka”.

Blloku perbehet ne disa segmente si me poshte:

Segmenti rrugor “1”.

Rruga "Dhori Guri" perbehet nga dy degezime qe ndodhen ne te majte te rruges se Kokonozeve. Gjatesia e ketij segmenti shkon rreth 240 ml me nje gjeresi 3.0-8.6m.

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

Segmenti rrugor “2”

Rruga "Zana Floqi" dhe degezimet ne te majte te saj.

Gjatesia e ketij segmenti eshte 439 ml dhe gjeresia e tij varion nga 4.7 – 7.6 ml.

Segmenti rrugor “3”

Rruga "Filip Shiroka" dhe degezimet ne te majte te saj.

Gjatesia e ketij segmenti eshte , perfshire edhe degezimin ne krah te majte te saj , eshte 340 ml dhe gjeresia e tij varion nga 4.0 – 6.6 ml.

Segmenti rrugor “4”

Rruga "Ernest Novak"

Qellimi i projektit

Objekt i projektit “Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”- “Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, njesia administrative nr.3 ne qytetin e Tiranës do te jete rehabilitimi bllokut me te gjithë elementet e infrastruktures rrugore, me qellim permiresimin e cilesise se jetes se komunitetit te kesaj zone, konkretisht ndertimin e shtresave rrugore, trotuareve, ndriçimin, kanalizimet e ujerave te zeza e te bardha dhe gjelberimin.

Nje vemendje te veçante ne projekt, do t’i kushtohet edhe elementeve te mobilimit urban (ne ato zona ku do jete e mundur) si psh. perdorimi pergjate te gjithë rruges i stolave, koshave te mbeturinave, vendit te vendosjes se konteinereve dhe te largimit publik te mbeturinave, zgarave apo rrethimeve te pemeve, kangjellave kufizuese ne trotuare si dhe bllokues te mjeteve ne trotuare, etj., duke bere te mundur krijimin e nje zone mjaft komode per levizjen dhe per jetesen ne zonat e banuara qe kane akses ne rruget qe parashikohen te rehabilitohen ne njesine administrative nr.3 ne kryeqytet.

Gjithashtu ne projekt do te mbahen parasysh te gjitha normat e miratuara per personat me aftesi te kufizuar, te verberit, etj. per te mundesuar nje ambient sa me miqesor edhe me kete pjese te komunitetit.


Sipas detyres se projektimit i gjithë blloku qe kufizohet nga rruget “Marie Kraja”, “Kokonozet”, “Zana Floqi” dhe “Filip Shiroka” do te kthehet ne nje zone urbane banimi ne te cilen qarkullimi automobilistik do te permiresohet nepermjet nderhyrjeve te reja qe parashikohen te behen duke krijuar gjithashtu disa zona te reja zhvillimore.

Gjatesia e ketij segmenti eshte rreth 97 ml dhe gjeresia e tij varion nga 3.0 – 4.4 ml.

Raport paraprak VNM, “Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”- “Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.

Gjendja ekzistuese

Gjendja e infrastruktures ne kete rrugë paraqitet si me poshte:



**Raport paraprak VNM,
"Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget "Marie Kraja"- "Kokonozet"-
"Zana Floqi"- "Filip Shiroka", Tirane.**

Infrastruktura rrugore

Per pershkrimin e gjendjes ekzistues te gjurmës ku do te shtrihet objekti i ri, blloku është trajtuar ne kater segmente kryesore si me poshte:

Segmenti rrugor "1".Rruga "Dhori Guri", shtrihet ne pjesen veri-perendimore te bllokut (ne krah te rruges se Kokonozeve), e cila perbehet nga disa segmente te shkurtra. Gjatesia totale e ketij segmenti shkon rreth 260-280 ml me nje gjerësi 3.0-8.6m. Gjendja e pergjithshme e ketyre segmenteve është jo e mire, me shtresa cfaredo, shtresa cakelli, shtresa betoni dhe dheu natyror, etj. Nje pjese e rruges (degezimi ne hyrje) shfrytezohet si parkim nga banoret e zones dhe rruga vete ka nje pjerresi te konsiderueshme. Infrastruktura mungon ne te gjithe gjatesine e saj, perfshire edhe ndricimi rrugor.



Segmenti rrugor "2".

Rruga "Zana Floqi" dhe degezimet rrugore ne krahun e majte te saj kane nje gjatesi te pergjithshme 574 ml dhe gjerësi, e cila varion nga 4.7 - 7.6 ml.

Segmenti rrugor "Zana Floqi" lidh segmentin rrugor "Filip Shiroka", me segmentin rrugor "Rr. e Kokonozeve".

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

Ne te gjithë gjatesine e ketyre segmenteve mungojne pergjithesisht paketa e shtresave asfaltike, me te gjithë elementet perberes te saj (perjashtim ben pjesa ne hyrje e ketij segmenti, e cila paraqitet pjeserisht me nje shtrese asfaltobetoni, pa nenshtresa). Aksesueshmeria ne banesat private me ane te ketij aksi rrugor eshte mjaft e veshtire per shkak se rruga eshte e ngushte dhe shume e demtuar. Infrastruktura inxhinierike mungon ne te gjithë gjatesine e saj, perfshire edhe ndricimi rrugor.



**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

Segmenti rrugor “3”.

Rruga "Filip Shiroka" dhe degezimi ne te majte te saj.

Gjatesia e segmentit rrugor "Rr.Filip Shiroka" perfshire edhe degezimin ne krah te majte te saj, eshte 348 ml dhe gjeresia e tij varion nga 3.2 - 6.6 ml.

Segmenti rrugor "Rr.Filip Shiroka" ka shtresa asfaltike, ne te gjithe gjatesine e saj, por ne disa pjese eshte e demtuar. Degezimi ne krah te majte te saj eshte pa shtresa asfaltike.

Infrastruktura inxhinierike per segmentin rrugor "Rr.Filip Shiroka" ekziston pergjithesisht (perjashtim ben rrjeti i ndricimit), ndersa per segmentin tjetër ne krah te majte te saj, mungon ne te gjithe gjatesine e saj, perfshire edhe ndricimi rrugor.



**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**





Segmenti rrugor “4”

Rruga "Ernest Novak", shtrihet ne krahun perendimor te bllokut. Gjatesia e ketij segmenti eshte rreth 97 ml dhe gjeresia e tij varion nga 3.2 - 4.6ml. Rrugica ka mungese infrastrukture dhe rrjete inxhinierike ne te gjithe gjatesine e saj dhe sherben per akses ne banesat rezidenciale.



Raport paraprak VNM, “Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”- “Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.



 BASHKIA E TIRANËS			
EMRI I PROJEKTTIT STUDIOSI - PROJEKTI - RIKUALIFIKIM I BLOKUT KUFIZUAR NGA RRUGËT "MARIE KRAJA" - "KOKONAZET" - "ZANA FLOQI" - "FILIP SHIROKA"			
FIRMA PROIEKTORE JV "STUDIO - REBUS" shpk & HIDROWATER ALBANIA shpk			
Nr. 55 "S" SHIRËG Nr. "M" SHIRËG SHIRËG Nr. 279A / 7 SHIRËG SHIRËG SHIRËG SHIRËG SHIRËG SHIRËG			
PROIEKTUES			
TITULLI	EMRI	SHIRËG	FIRMA
ARKITEKTI	Ark. Reduan TOPKA	Ark. Gentian TOPCU	
KONSTRUKTORI	Enk. Tahir Gashaj		
SHKENCË	Enk. Arjan Pustina		
MEKANIKE	Enk. Anx Pajo		
ELEKTRIKE	Enk. Mirjeta Drenu		
TOPOGRAFI	Enk. Vjollza Kodra		
SHIRËG			
SHIRËGJIT I FLETES PLANMETRIA E RRUGËVE			
REVIZIONET			
REV 01			
REV 02			
EDR		FIRMA	DATA
1 : 500			2023
SHIRËG			DATA
PIPe			B.1 - 03
PAGA	PROIEKTI		NR.FLETES

Raport paraprak VNM, “Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”- “Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.



Raport paraprak VNM, “Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”- “Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.




Fig. Planvendosjet e detajuara

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

1.2 KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

Procesi i hartimit të Vleresimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), ndihmon në përmirësimin e çdo lloji projekti në respektimin dhe mbrojtjen maksimale të mjedisit të zonës ku ai zbatohet.

Qëllimi i VNM-se është që të sigurojë që mjedisi në zonën ku zbatohet projekti do të konsiderohet i lidhur me gjithë ceshtjet e tjera të rëndësishme, në çdo etapë të tij.

Ky raport është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor në fuqi dhe ka për qëllim të identifikojë, parashikojë dhe vleresojë gjithë ndikimet e mundshme në mënyrë sistematike, të kuptueshme dhe objektive.

VNM-ja është vlerësimi mjedisor në një proces vlerësimesh (të mjedisit, planifikimit hapësor, ndertimit, etj.) që eventualisht mund të finalizohet me Lejen e Zhvillimit.

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis në fakt i përgjigjet në thelb këtyre pyetjeve kyç:

A. Si do të ishte mjedisi pa projektin? (për shembull Studimet Baze). Kjo do të identifikojë dhe përshkruajë gjendjen aktuale të burimeve dhe karakteristikat ekzistuese në mjedisin që mund të ndikohet nga projekti dhe se si këto do të zhvillohen në mungesë të projektit.

B. Çfarë do t'i ndodhë mjedisit, si pasoje e projektit? (për shembull Parashikimi). Kjo do të përshkruajë mjedisin siç është pa projektin dhe se si ai do të ndryshojë si pasoje e projektit në aspektin e burimeve mjedisore apo njerezve (receptoret) që janë të ndikuar, natyrën dhe shkallën e ndryshimit, shtrirjen e tij gjeografike dhe kohore.

C. A përben kjo një shqetësim? (për shembull Vlerësimi) Parashikimi i ndikimit nuk është i mjaftueshëm.

D. Nëse është i rëndësishëm a mund të bëjmë ndonjë gjë në lidhje me të? (për shembull Zbutja). Në fund, është e rëndësishme të kuptohet se, në qoftë se ndikimi është i rëndësishëm, mund të bëhet dicka për të shmangur, reduktuar, korrigjuar apo kompensuar për të. Zhvilluesi i projektit mund t'i përfshijë këto masa zbutëse në propozimet e projektit dhe autoriteti kompetent mund t'i përfshijë kërkesat përkatëse në kushtet e lejes së dhënë.

Në mënyrë që autoritetet kompetente dhe palët jashtë të interesuara të vendosin nëse projekti duhet të vazhdojë, është thelbësore që informacioni mjedisor i dhënë nga zhvilluesi në Raportin e VNM-se, t'i përgjigjet në mënyrë të qartë pyetjeve të mësipërme. Qëllimi i studimeve të VNM është që të gjenerojë dhe paraqesë informacion në mënyrë të qartë, koherente dhe të sakte.

Idea e VNM-se është të sigurojë informacion për vendim marrësit dhe publikun mbi pasojat mjedisore të zhvillimeve të reja të propozuara. Për më tepër ideja është që të

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

promovohet zhvillimi qe respekton mjedisin permes identifikimit te masave te duhura forcuese dhe zbutese.

Objektivi kryesor i VNM-se eshte te identifikojte ndikimet e mundshme negative mjedisore te projekteve te reja te zhvillimit. Brenda ketij qellimi, procesi i VNM-se kerkon qe:

- te konsiderohen alternativat per vendndodhjen dhe ndikimet mjedisore shoqeruese;
- te permiresohet plani mjedisor i propozimit;
- te sigurohet qe burimet jane perdorur si duhet dhe ne menyre eficente;
- te identifikohen masat e duhura per zbutjen e ndikimeve te mundshme te propozimit;
- te vendosen kushtet per ndertimin; dhe
- te ndihmohet vendimmarrja dhe informimi i publikut.

Procedura e VNM-se perfshin:

- a. procesin paraprak te VNM-se;
- b. procesin e thelluar te VNM-se.

Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM) shyrton kerkesat per vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe ne fund te seciles procedure, paraprake apo te thelluar te VNM-se, merr Vendimin per VNM-ne paraprake, ndersa per VNM-ne e thelluar pergatit Deklaraten Mjedisore me rekomandimet perkatese dhe i'a degon Ministrise.

Ne perfundim vendim marrja konsiston ne:

- Vendim - leshuar nga AKM-ja ne perfundim te procedures paraprake te VNM-se
- Deklarate Mjedisore - leshuar nga Ministri ne perfundim te procedures se thelluar te VNM-se

Vendimi

Vendimi i AKM-se ne fund te procedures Paraprake te VNM-se percakton nese nje projekt i listuar ne Shtojcen II te Ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, ne fuqi, duhet apo jo t'i nenshtrohet procedures se thelluar te VNM-se. Nese AKM-ja vendos se projekti nuk duhet t'i nenshtrohet procedures se thelluar te VNM-se, ne vendimin e saj percakton arsyet dhe konsideratat kryesore ku eshte mbeshtetur mendimi, mendimin e institucioneve te konsultuara, pershkrimin sipas rastit, te masave kryesore qe duhen marre per te shmangur, reduktuar dhe nese eshte e mundur per te korrigjuar ndikimet negative te mundshme ne mjedis.

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

Deklarata Mjedisore

Rezultati perfundimtar i procedures se thelluar te VNM-se, eshte Deklarata Mjedisore, e cila mund te permbaje refuzimin ose miratimin me rekomandime per Autoritetin e Planifikimit per te vazhduar procesin ne baze te kushteve te specifikuara mjedisore.

Deklarata mjedisore sherben si dokument orientues per Autoritetin e Planifikimit dhe/ose cdo autoritet pergjegjes ne procesin e vendim marrjes, per nje leje zhvillimi apo per nje leje te caktuar per miratimin e nje projekti te listuar ne Shtojcat 1 dhe 2 te ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, ne fuqi.

Dokument i baze ku mbeshtetet procesi i VNM-se, eshte raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis, i cili ne varesi te ndikimeve te mundshme te projektit mund te jete:

- a. raport paraprak i VNM-se per projektet e shtojces II te ligjit nr. 10440, date 07.07.2011'Per vleresimin e ndikimit ne mjedis' te ndryshuar;
- b. raport i thelluar i VNM-se per projektet e shtojces I te ligjit nr. 10440, date 07.07.2011'Per vleresimin e ndikimit ne mjedis' te ndryshuar.

Baza ligjore

1. Ligji nr. 10431, date 09.06.2011 'Per mbrojtjen e mjedisit', te ndryshuar;
2. Ligji nr. 10440, date 07.07.2011 'Per vleresimin e ndikimit ne mjedis', te ndryshuar;
3. Ligji nr.10006, date 23.10.2008 "Per mbrojtjen e faunes se eger"
4. Ligji nr. 8906, date 6.6.2002 "Per zonat e mbrojtura" ndryshuar me ligjin, Nr.9868, date 4.2.2008 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.8906 date 6.6.2002 "Per zonat e mbrojtura"
5. Ligji nr.10 253, date 11.3.2010 "Per gjuetine"
6. Ligji Nr. 9533, date 15.5.2006 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
7. Ligji Nr. 9791, date 23.7.2007 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
8. Ligji Nr. 15/2012, Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
9. Ligji Nr. 36/2013, Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
10. Ligji Nr. 38/2013 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9693, date 19.03.2007 "Per fondin kullosor te ndryshuar"

**Raport paraprak VNM,
"Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget "Marie Kraja"- "Kokonozet"-
"Zana Floqi"- "Filip Shiroka", Tirane.**

11. Ligji Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
12. Ligji nr. 68/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9587, date 20.7.2006, "Per mbrojtjen e biodiversitetit", te ndryshuar.
13. Ligji nr. 162/2014 "Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis"
14. VKM nr. 686, date 29.07.2015 'Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis(VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit dhe deklarates mjedisore';
15. VKM nr. 247, date 30.04.2014 "Per percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore"
16. Ligji nr. 10 463, date 22.9. 2011"Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", te ndryshuar;
17. VKM nr. 575 date 24.06.2015 "Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte"
18. VKM nr.175, date 19.1.2011 "Per miratimin e strategjise kombetare te menaxhimit te mbetjeve dhe te planit kombetar te menaxhimit te mbetjeve"
19. VKM nr. 371, date 11.06.2014 "Per percaktimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe miratimin e dokumentit te dorezimit te mbetjeve te rrezikshme"
20. VKM nr. 418, date 25.06.2014 "Per grumbullimin e diferencuar te mbetjeve ne burim"
21. VKM nr. 229, date 23. 04. 2014 "Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe te dokumentit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme"
22. VKM nr.519, date 30.6.2010 "Parqet Natyror Rajonal"
23. Vendim Nr. 22, date 9.1.2008 "Per caktimin e procedurave dhe te kriterëve te administrimit te pyllit komunal"
24. Vendim Nr. 1354, date 10.10.2008 "Per rregullat dhe procedurat qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullor"
25. Vendim Nr. 396, date 21.06.2006 "Per kriteret e transferimit dhe te perdorimit te pyjeve nga njesite e qeverisjes vendore"
26. VKM nr.897. date 21.2.2011 "Miratimi i Rregullave per Shpalljen e Zonave te Vecanta te Ruajtjes"
27. VKM nr. 532, date 05.10.2000 "Per miratimin e studimit "Strategjia dhe Plani i veprimit per biodiversitetin"
28. VKM nr. 676, date 20.12.2002 "Per shpalljen zone e mbrojtur te monumenteve te natyres shqiptare"
29. VKM nr. 594, date 10.09.2014 "Per miratimin e Strategjise Kombetare per cilesine e ajrit te mjedisit"

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

30. Vendimi Nr. 435, date 12.9.2002 “Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise”

31. VKM nr 352, date 29.04.2015. “Per vleresimin e cilesise se ajrit te mjedisit dhe kerkesat per disa ndotes ne lidhje me te”.

Objekt i ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, eshte percaktimi i kerkesave, pergjegjesive, rregullave dhe procedurave per vleresimin e ndikimeve te rendesishme negative mjedisore te projekteve te propozuara, private ose publike.

Sipas ligjit Per Mbrojtjen e Mjedisit, vleresimi i ndikimit ne mjedis i nje projekti te propozuar zhvillimi eshte vleresimi i ndikimeve te rendesishme, te mundshme te asaj veprimtarie ne mjedis.

Gjate procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis, kryhen identifikimi, pershkrimi dhe vleresimi ne menyren e duhur i ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie, duke percaktuar efektet e mundshme te drejtperdrejta dhe jo te drejtperdrejta mbi token, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimen, shendetin e njeriut, floren dhe faunen, peizazhin natyror, pasurite materiale, trashegimine kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre te ndersjella.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis zbaton parimin e parandalimit qe ne fazen e hershme te planifikimit te projektit, me qellim shmangien apo minimizimin e efekteve negative ne mjedis, permes harmonizimit dhe pershtatjes se saj me kapacitetin bartes te mjedisit. Vleresimi i ndikimit ne mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjese e pergatitjeve per planifikimin e nje projekti zhvillimi dhe para kerkimit te lejeve perkatese te zhvillimit. Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, dhe aktet nenligjore qe rrjedhin prej tij, te perafuara plotesisht me Direktiven e bashkimit Evropian per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis ka per qellim te siguroje nje nivel te larte te mbrojtjes se mjedisit, permes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit te demeve ne mjedis, nga projekte te propozuara para miratimit te tyre per zhvillim dhe garantimin e nje procesi te hapur vendimmarrjeje, gjate identifikimit, pershkrimimit dhe vleresimit te ndikimeve negative ne mjedis, ne menyren dhe kohen e duhur si dhe perfshirjen e te gjitha paleve te interesuara ne te.

Ky ligj zbatohet per projektet e propozuara, private apo publike, te cilat mund te shkaktojne ndikime te rendesishme negative, te drejtperdrejta ose jo, ne mjedis, si pasoje e madhesise, natyres apo vendndodhjes se tyre.

Kerkesa te pergjithshme per vleresimin e ndikimit ne mjedis te nje projekti:

- Vleresimi i ndikimit ne mjedis perfshin percaktimin, pershkrimin dhe vleresimin e ndikimeve te pritshme te drejtperdrejta e jo te drejtperdrejta mjedisore te zbatimit apo moszbatimit te projektit.

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

- Ndikimet mjedisore te projektit vleresohen ne lidhje me gjendjen e mjedisit ne territorin e prekur ne kohen e paraqitjes se raportit perkates per vleresimin e ndikimit ne mjedis te projektit.
- Vleresimi i ndikimit ne mjedis perfshin pergatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes se veprimtarise, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zones ne gjendjen e meparshme, nese nje detyrim i tille parashikohet me ligj. Vleresimi perfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundesine per aksidente.
- Vleresimi i projektit perfshin, gjithashtu, propozimin e masave te nevojshme per parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve te tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjate zbatimit te projektit, perfshire edhe vleresimin e efekteve te pritshme te masave te propozuara.

Aspektet me te rendesishme te procesit paraprak te VNM-se, jane konsultimet me palet e tjera dhe vendimi nese kerkohet nje VNM e thelluar.

VNM paraprak eshte faza e pare e procesit te VNM. Sipas Nenit 8 te ligjit te VNM qellimi i VNM Paraprak eshte te identifikojte propozimet qe kerkojne VNM te thelluar. VNM Paraprak perjashton nga procesi ato propozime (shumicen) qe nuk kane ndikime te rendesishme, ose pak, ndikime lehtesisht te kontrollueshme, dhe per te cilat VNM eshte e panevojshme. Ne vijim, Tabelat dhe Listat e Kontrollit do te ndihmojne ne procesin i cili vendos nese kerkohet VNM per nje projekt te vecante ose tip projekti.

Tre fazat kryesore e VNM Paraprak jane:

- **Paraqitja e kerkeses** dhe dokumentacionit shoqerues nga zhvilluesi ne Ministrine e Mjedisit, kontrolli administrativ paraprak i aplikimit nga Ministria e Mjedisit dhe percjellja e tyre nga Ministria ne Agjencine Kombetare te Mjedisit (AKM);
- Kontrolli teknik **paraprak** i bere nga AKM dhe **konsultimi** i AKM **me insitucionet e tjera** dhe **publikimi** i aplikimit;
- AKM njofton per **vendimin e marre**, nese projekti eshte apo jo e nevojshme ti nenshtrohet procedures se thelluar te VNM, Ministrine e Mjedisit (MM) dhe palet e perfshira ne proces, dhe publikon vendimin ne faqen e internetit te AKM.

Konventat dhe marrveshjet nderkombetare ne lidhje me procesin e VNM-se

Direktiva e Këshillit të BE-së 97/11/EC e cila modifikoi Direktivën 85/337/EEC mbi Vlerësimin e Disa Projekteve Publike e Private, parashikon qe autoritetet kompetente të shteteve anëtare të kërkojnë kryerjen e një vlerësimi të ndikimitmjedisor (VNM) për projektet që mund te rezultojne me ndikim domethënës në mjedis. VNM duhet të pergatitet para miratimit të projektit, në mënyrë që vendimi për miratim të marre

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

paraysh ndikimet e mundshme të projektit në mjedis. Direktiva paraqet një listë të projekteve që kërkojnë studimin e VNM në të tëra rastet (Shtojca 1) dhe një listë të projekteve që mund të kërkojnë një studim të permblëdhur VNM (Shtojca 2), në varësi të një vlerësimi për ndikimet e mundshme që mund të rezultojnë nga projekti i propozuar apo të kriterëve kufizues, të vendosura nga secili shtet anëtar. Propozimi aktual konsiderohet si një projekt i Shtojcës 2.

Direktiva kërkon që “VNM të identifikojë, përshkruajë e vlerësojë në mënyrën e duhur ndikimet e drejtpërdrejta e indirekte të një projekti për:

- Qëniet njerëzore, floren dhe faunen;
- Tokën, ujin, klimën dhe peizazhin;
- Asetet materiale të trashëgimia kulturore; dhe
- Ndërveprimin midis faktorëve të lartpërmendur.

Informacioni tjetër që përcaktohet në direktive që duhet të përfshihen në studimin e VNM-se jepet në Shtojcën IV të Direktivës 97/11/EC dhe ajo përfshin:

- një përshkrim të projektit;
- një përvijim të alternativave kryesore të vendodhjes dhe të teknologjise të marra në shqyrtim për projektin e propozuar;
- një përshkrim të aspekteve të mjedisit që mund të ndikohen me shume nga projekti e që lidhen me popullsinë, florën, faunën, tokën, ujin, faktorët klimatik, asetet materiale, pejsazhin e raportin reciprok mes faktorëve të lartpërmendur;
- një përshkrim të ndikimeve domethënëse të projektit që dalin në pah nga ekzistenca e vetë projektit, shfrytëzimi i burimeve natyrore, cilrimi/shkarkimi i lëndëve ndotëse, krijimi i zhurmave dhe trajtimi i mbetjeve;
- një përshkrim i masave të parashikuara për parandalimin, uljen dhe aty ku është e mundur, mënjanimin e efekteve të dëmshme në mjedis; dhe
- një përmbledhje jo-teknike e informacionit të siguruar.

Direktiva 97/11/EC (amenduar nga Direktiva 2003/35/EC pas nënshkrimit të Konventës së Aarhus nga Komuniteti, më 25 Qershor 1998, mbi pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje dhe akses në vendosjen e drejtësisë në çështjet mjedisore) gjithashtu parashikon konsultimin me publikun, në fazën e propozimit e mbledhjes së informacionit, për t'i dhënë publikut të interesuar mundësinë për të shprehur mendimin e tyre para marrjes së vendimit lidhur me zhvillimin e propozuar.

Shqipëria është anëtare dhe ndjek detyrimet e konventave të mëposhtme ndërkombetare:

- Konventa e Bernit (CH) “Për mbrojtjen e flores dhe faunes së eger dhe mjedisin e saj natyror në Evropë.”, miratuar me ane të ligjit nr 8690, më 2 Mars 1998;

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

- Konventa e Barcelones “Per mbrojtjen e mjedisit detar dhe ujqor te Mesdheut” dhe protokollet e saj;
- Konventa e Bonit “Mbi mbrojtjen e faunes se eger shtegtare”;
- Konventa e Vienes “Mbi kontrollin e kalimit kufitar te mbetjeve te rrezikshme dhe asgjesimin e tyre”, miratuar me ane te ligjit nr. 8216, me 13 Prill 1997;
- Konventa e Vienes “Per mbrojtjen e shtreses se Ozonit” dhe protokolli i Montrealit “Mbi substancat qe demtojne shtresen e Ozonit”;
- Konventa e Aarhusit “Mbi te drejten e publikut per t’u informuar, per pjesemarrje ne vendim-marrje dhe e drejta per t’iu drejtuar organeve te drejtesise per ceshtjet mjedisore”, miratuar me ligjin nr. 8672, me 26 Tetor 2000;
- Konventa “Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis ne kuadrin Nderkombetar”. Hyr ne fuqi ne 4 Tetor 1991;
- Konventa e Kombeve te Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike, Tetor 1994;
- Konventa e Kombeve te Bashkuara mbi Biodiversitetin, Janar 1994;
- Kombet e Bashkuara “Konventa kunder zgjerimit te shkretetirave ne vendet e thata, vecanerisht ne Afrike”. Hyrja ne fuqi me 27 Prill 2000.

2. PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES KU PROPOZOHET TE ZBATOHET PROJEKTI

Zona ku do te zhvillohet projekti eshte nje zone tipike urbane, madje edhe perpara viteve '90 ajo ka qene identifikuar si nje nga zonat me te populluara te qytetit te Tiranes.

Mund te themi me siguri, se ne siperfaqen e zones ne studim nuk ekziston asnje mbulesa bimore e qendrueshme, kjo referuar faktit se ne kete siperfaqe dhe ne zonat perreth saj pemet e mbjella jane sporadike dhe zona eshte teresisht urbane, sic u permend me siper. Te vetmet bime qe mund te hasen perreth kesaj siperfaqe jane pemet dekorative pergjate rruges, te mbjella nga Bashkia Tirane apo disa bime dekorative apo peme frutore qe gjenden ne oborret e disa pronave private perreth. Por numri i tyre eshte teper i kufizuar, sic mund te verehet ne figuren e meposhtme.

Ne nivel bashkie, pra Bashkise Tirane, mund te bejme nje pershkrim te pergjithshem te flores dhe faunes .

FLORA E TIRANES

Ne territorin e Bashkise Tirane jane identifikuar rreth 655 lloj bimesh, shifer qe perfaqeson rreth 20% te flores ne gjithe Shqiperine, cka do te thote, qe territori i Tiranes ka nje numer dominant te llojesh, ne raport me siperfaqen e pergjithshme.

Bimesia ne perqindje me te larte eshte e perhapur ne territorin kodrinor dhe malor. Nder rrisqet qe cenojne floren vecojme moszbatimin e kritereve teknike gjate procesit te grumbullimit te bimesive, kullotja dhe zjarret si dhe mungesa e informimit dhe sensibilizimit te komunitetit. Kjo pasuri natyrore duhet vleresuar dhe menaxhuar mbi baza tekniko-shkencore, pasi konsiderohet si vlere e vecante, prandaj shihet domosdoshmeria studimit dhe inventarizimit te bimeve mjekesore, eterovajore, e tanifere ne shkalle bashkie.

Nder llojet me vlere te larte ne fushen farmaceutike dhe mjekesise popullore vecojme:

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

- | | |
|-----------------------|----------------------|
| 1. Trumëz | 27. Bar blete |
| 2. Luleshtrydhe | 28. Qikore |
| 3. Sherebel | 29. Çantë bariu |
| 4. Bar majaselli | 30. Gjethe delli |
| 5. Tërfil i kuq | 31. Bar gjahu |
| 6. Thundër mushke | 32. Mellage |
| 7. Zhumbricë | 33. Neptull |
| 8. Rigon i bardhë | 34. Kamomil |
| 9. Rigon i kuq | 35. Këmbë ujku |
| 10. Gjuhë nuse | 36. Koreandro |
| 11. Borzilok | 37. Sinapi i bardhë |
| 12. Sinap i bardhë | 38. Lule shqere |
| 13. Mjedër | 39. Trëndali i egër |
| 14. Hithër | 40. Shtog i zi |
| 15. Tërfi i bardhë | 41. Kulumbri |
| 16. Mentë | 42. Dëllinjë e kuqe |
| 17. Lule balsami | 43. Dëllinje e zezë |
| 18. Njëmijëfletësh | 44. Murriz |
| 19. Kokoçeli | 45. Gështenjë |
| 20. Manaferra | 46. Xana |
| 21. Rozmarina | 47. Xinë |
| 22. Lulëkuqe | 48. Mare |
| 23. Kinfushë | 49. Mersinë |
| 24. Thundërmushke | 50. Frashër i bardhë |
| 25. Bar pate | 51. Akacie |
| 26. Sporisi mjekësore | 52. Bli |

FAUNA E TIRANES

Fauna vleresohet e pasur me shume lloje dominante qe paraqesin nje trashegimi te rendesishme ne nivelin kombetar dhe nderkombetar.

Ne hapesiren e Bashkise se Tiranes jane 23 lloje me interes global ruajtje, duke perfshire 14 lloje gjitaresh, 3 lloje zvarranikesh, 2 lloje amfibesh dhe 4 lloje insektesh. Pothuajse 2/3 e llojeve me status perkujdesje globale jane gjitaret, 7 prej te cileve jane lakuriq nate, banore te shpellave. Kjo evidenton rendesine e Shpelles se Zeze (Pellumbasit) si vendstrehimi kryesor i lakuriqit te nates.

Shpendet qe gjallojne ne Tirane vleresohen si te larmishe, rreth 143 lloje, prej te cileve 77 jane te perhershem, 38 jane verues dhe 7 jane shtegetare. Nga ta 84 lloj shpendesh jane te lidhur me pyjet, ndersa 59 lloje konsiderohen si shpend jopyjor.

Nder gjitaret me te perhapur konsiderohen: ujku, kaprodhi, derr i eger, ariu, lepuri, etj. Nenvizojme, se nder vite, nuk ka patur sjellje miqesore ndaj kafsheve nga komuniteti

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

vendor dhe publiku. Nder rreziqet kryesore te faunes ne hapësirën e rrethit te Tiranës mbeten vrasja dhe perndjekja e kafsheve, gjuetia, copezimi dhe humbja e habitatit, kullotja, zjarret, veprimtarite industriale si dhe aktivitete te pa licensuara.

Pas ngritjes se baze te te dhenave, inventarizimit, u vu re se mesatarja e 2/3 te llojeve qe gjenden ne Shqiperi ndodhen edhe ne arealin e Bashkise se Tiranës (tabela e meposhtme).

Klasa	Numri i llojeve të konstatuara në ha	Numri i llojeve në listën kombëtare	Përqindja (%)
Gjitarët	44	71	62
Shpendët	143	330	43
Zvarranikët	25	37	67
Amfibët	12	15	80
Insektet	229		-

Klasa	Llojet kombëtare të kërcënuara në Tiranë	Përqindja e klasës
Gjitarët	29	66
Shpendët	35	24
Zvarranikët	17	89
Amfibët	10	83
Insektet	42	18
Totali	133	

Sic shihet ne tabelen e mesiperme, 133 lloje jane te perfshira ne Librin e Kuq te Shqiperise, qe konsiderohen te mbrojtura dhe ne rrezik zhdukjeje.

Zonat e mbrojtura

Ne Shqiperi, Zonat e Mbrojtura jane te konsideruara si pjese/siperfaqe e tokes dhe/ose ujit, detare/bregdetare, te destinuara kryesisht per konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore qe shoqerojne ate/ato dhe qe jane te menaxhuara ne menyre te ligjshme dhe/ose ne menyra te tjera efektive. Rrjeti i zonave

Raport paraprak VNM, “Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”- “Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.

te mbrojtura eshte bazuar ne kategorite e menaxhimit te IUCN dhe sistemi i ndertuar per kete qellim eshte ne perputhje me sistemin nderkombetar IUCN. Te gjashte kategorite e sistemit jane ekuivalente, te barabarta dhe te rëndesishme dhe ato perfshijne te gjitha nivelet e nderhyrjes njerezore, te pranueshme per kategorine respektive. Krijimi i Zonave te Mbrojtura ka filluar qe ne vitin 1940. Ne 1981, per here te pare, asete te rralla natyrore u vendosen ne mbrojtjen shteterore duke shpallur si Monumete te Natyres pyjet me vlere shkencore, biologjike, historike dhe didaktike.

Zona ne vleresim nuk vleresohet si zone me status te vecante mjedisore apo biodiversiteti nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe nga Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura.

Sic mund te verehet edhe ne figuren e meposhtme, objekti ndodhet ne distance mbi 8 km nga kufiri i ZM “Mali i Dajtit” dhe fakti qe ndodhet ne nje zone urbane, nuk asnje lloj ndikimi ne zonat e mbrojtura epo monumentet e natyres te bashkise apo qarkut Tirane.




Fig. Distanca nga ZM “Mali i Dajtit”

3. INFORMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE, NE SIPERFAQEN E KERKUAR NGA PROJEKTI DHE NE AFERSI TE TIJ ZBATOHET PROJEKTI

Sic eshte shpjeguar edhe me siper, zona ku do te zhvillohet projekti eshte nje zone tipike urbane, madje edhe perpara viteve '90 ajo ka qene identifikuar si nje nga zonat me te populluara te qytetit te Tiranes.

Zona ne studim ben pjese ne basenin Ishem.

Gjithsesi, ne vija te pergjithshme, Shqiperia zoteron burime te bollshme te ujit. Edhe pse sasite jane te mjaftueshme per nevojat aktuale, cilesia e tyre shpesh eshte problem per shkak te ndotjes se tanishme dhe historike, sidomos ne zonat e uleta fushore ku jeton pjesa me e madhe e popullsisë dhe ku zhvillohen pjesa me e madhe e aktiviteteve industriale dhe bujqesore. Problem tjetër mbetet shperndarja jo e njetrajtshme e burimeve ujore ne vend. Burimet e pergjithshme, te riparteritshme, te ujit ne Shqiperi perdoren per qellime urbane, industriale dhe bujqesore si edhe per sigurimin e prodhimit te energjise elektrike nga hidrocentralet.

Ujrat siperfaqesore dhe ato nentokesore jane te lidhur dhe varen nga njeri tjetri, por konsiderohen burime te ndara. Shqiperia ka gjashte lumenj te medhenj, ka liqene te medha nderkufitare dhe te lundrueshme, si dhe formacione te rendesishme ujembajtese, megjithate burimet ujore jane te shperndara ne menyre jo te barabarte ne vend. Ne vend ka hidrocentrale dhe rezervuare vaditjeje si dhe nje numer lagunash dhe mocalesh me vlere. Shqiperia renditet midis vendeve qe kane potenciale te medha me uje, baras me 8600 m^3 per fryme ne vit.


Derdhja mesatare vjetore e ujit ne det eshte $40,5 \text{ bilion m}^3$, e cila korrespondon me nje derdhje prej $1300 \text{ m}^3/\text{sek}$. Reshjet jane nje burim i rendesishem i ujit me nje mesatare aktuale vjetore prej 1485 mm/vit . Burimet e ujerave siperfaqesor perdoren per prodhimin e energjise (hidro-energja), industri dhe vaditje ku formacionet ujembajtese jane shume produktive dhe furnizojne me uje te pijshem shumicen e popullsisë urbane.

Uji perdoret ne te gjitha aspektet e jetes dhe eshte i rendesishem per perdoruesit publik dhe industriale. Si rrjedhoje e sistemeve te papershtatshme te monitorimit, ndryshimet e shpejta ne aktivitetet ekonomike dhe popullsi eshte e veshtire te vleresohet perdorimi i ujit ne terma te sakte.

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

Tabela. Vleresim i perafert i perdorimit te ujit ne Shqiperi

Perdorimi i Ujit	Volumi(bilion m³)
Hydrocentrale	14,0
Vaditje	1,013
626 rezervuare	0,560
Lumenj dhe Liqene	0,450
Uje Nentokesor	0,003
Uje i pijshem	0,22
Totali	16,246



Harte Baze e Baseneve Ujore ne Shqiperi

Raport paraprak VNM, “Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”- “Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.




Fig. Harta hidrogjeologjike e Qarkut të Tiranës

Pershkrimi i Mjedisit

Klima

Zona në studim përfshihet në zonën klimatike mesdhetare fushore të Shqipërisë. Kjo zonë karakterizohet nga dimër të butë dhe të lagët dhe verë të nxehtë dhe të thatë. Vendndëzimet kryesore të vecorive klimatike janë në Tiranë, Kamez dhe Sukthi.

Klima e rajonit të Tiranës është mesdhetare e karakterizuar nga një verë e nxehtë dhe relativisht e thatë si dhe me dimër të ftohtë dhe të lagësht. Për shkak të veprimtarisë së gjërë ciklonare sasia me e madhe e reshjeve vihen re në gjysmën e ftohtë të vitit, dhe ajo me e ulët në periudhën e ngrohtë të tij. Zona në studim është një nga zonat që karakterizohet nga sasi reshjesh vjetore të ulta mesatarisht 931mm në vit të cilat bien kryesisht në formë shiu. Muaji me më shumë reshje është muaji nëntor (132.9 mm), i ndjekur nga muaji dhjetor (113 mm).

Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.




Fig. Zonat Klimatike te Shqiperise

Muaji me me pak reshje eshte muaji korrik me 23.9 mm. Numri I diteve me reshje ≥ 1.0 mm varion nga 2.4 dite (korrik) deri ne 11.1 dite (dhjetor). Gjate vitit ka mesatarisht 86.4 dite me reshje ≥ 1.0 mm.

Zona ne studim nuk klasifikohet si zone me sasi te medha reshjesh 24-oreshe, ose me mire ajo ben pjese ne zonat ku shirat jane me pak te rrembyeshem. Megjithate nuk perjashtohen edhe rastet kur sasia maksimale 24-oreshe ka arritur 180.8mm dhe 182.5mm perkatesisht ne muajt nentor dhe tetor. Ndersa maksimumi 24h per periudhen 30 vjecare varion nga 43.0 mm ne korrik (per vleren me te ulet) deri ne 182.5 mm ne tetor te vitit 2002.

Rreshjet jane nje element i rendesishem meteorologjik, qe ne rajonin e Tiranës dhe Durrësit kryesisht perfaqesohen nga shiu. Ne tabelen me poshte paraqitet sasia e rreshjeve sipas muajve dhe numri i diteve me rreshje gjate vitit bazuar ne te dhenat shume vjecare meteorologjike.

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

Sasia e reshjeve mujore dhe numri i diteve me reshje gjate vitit bazuar ne te dhenat shume vjecare meterologjike

Muajt		01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12	Vjetor
Reshjet														
Reshjet mujore mm		112	98	86	60	57	28	12	20	35	131	164	150	983
Max 24 oresh mm		89	83.6	63	66.1	67	77	35	65.3	72.3	182.5	180.8	59	1042.6
Numri i diteve me reshje	0.1 mm	13.3	11.5	10.7	8.8	7.5	4.9	3.5	3.5	5.7	10.7	12.4	14.4	106.9
	5 mm	6.1	5.5	5.1	3.5	3.3	1.8	1.0	1.5	2.5	5.4	8.5	7.2	51.4
	10 mm	4.2	3.3	2.7	1.9	1.9	0.9	0.5	0.9	1.6	3.6	5.5	4.1	31.1

Temperatura e ajrit

Ne rajonin e Tiranës dhe Durrësit, temperatura e ujit është me e lartë në muajt e verës (Korrik – Gusht), ku edhe sasia e energjisë diellore është me e madhe, ndërsa temperatura me e ulët është në dimër, në muajin Shkurt. Përse i përket vecorive sezonale mund të pohojmë që gjysma e ngrohtë e vitit prill-shtator karakterizohet nga temperatura mesatare 20.6°C ndërsa gjysma e ftohtë 12.4 °C. Ecuria vjetore e temperaturave maksimale absolute të ajrit është e njëjte me atë të temperaturave mesatare, pra me një minimum në janar dhe maksimum në Korrik ose Gusht.

Temperaturat maksimale absolute >30°C fillojnë të regjistrohen që nga muaji Maj dhe vazhdojnë deri në Shtator. Temperatura maksimale absolute me e lartë e vrojtuar është 39.0°C në Korrik (viti 2007).

Një nga treguesit më të rëndësishëm për të karakterizuar temperaturat maksimale të ajrit është dhe mesatarja maksimale, vlerat e së cilës variojnë nga 12°C në Janar deri në 27.8°C në Korrik.

Minimumi absolut i tyre arrihet në muajin Janar (-6.0°C). Por duhet përmendur gjithashtu duke vlerat e ulta të këtij treguesi janë vrojtuar qysh në Nëntor (-1.6°C) deri në muajin Mars (-5.2 °C).

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

Kjo zone, ashtu si edhe ne rastin e rrezatimit diellor, karakterizohet nga nje numer I madh i oreve me diell. Mesatarisht gjate vitit ka 2655 ore me diell, me vleren me te larte ne korrik me 355 ore dhe ate me te ulet ne dhjetor me 107 ore.

Temperatura pergjate vitit ne zonen e Tiranës

Mujore Temperatura		01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12
Mesatare 0C		7.9	8.8	11.0	14.4	18.1	21.9	24.0	23.9	21.4	17.6	13.7	10.0
Mesatarja mujore	Me e larta	-11.6	11.7	14.2	16.6	20.7	23.8	26.2	25.8	24.0	20.2	15.8	12.1
	Me e ulta	4.1	5.4	7.8	11.9	16.7	19.4	22.7	21.0	19.6	15.2	11.9	6.4
Max.absolute		18.8	22.1	24.9	28.6	31.3	35.0	37.7	39.0	34.0	32.2	26.0	21.7
Min.absolute		-7.4	-4.6	-3.0	2.4	6.2	11.0	13.6	11.0	8.2	5.0	2.0	-7.2

Dijellezimi

Rajoni Tirane-Durres merr sasi te medha orresh diell. Vlera e zgjatjes vjetore te djellezimit levizne kufijte 2600-2700 ore.

Edhe numeri i diteve me diell leviz nga 320-330 dite. Vlerat me te larta jane vrojtuar ne korrik, 373 ore me diell, dhe me te ultat ne dhjetor 118 ore.

Edhe radiacioni diellor ndjek pothuaj te njejten shperndarje vjetore si dhe djellezimi. Energjia diellore mesatare gjate nje viti eshte 1600 kW ore/m², vleat me te larta jane vrojtuar ne korrik, 223.5 kW ore/m² dhe me te ultat ne dhjetor 52.9 kW ore/m². Ne tabelen e meposhtme jane dhene mesataret shumevjecare mujore te shperndarjes se djellezimit si dhe radiacioni diellor I pergjithshem.

Dijellezimi (ore) dhe radiacioni diellor (kW h/m²)

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	6.5	5.8	5.2	4.6	5.5	8.1	17.3	17.6	13.5	9.6	6.1	6.1	105.9
Kamez	5.7	5.5	4.7	4.6	5.7	8.0	16.2	16.0	12.3	9.6	5.6	6.1	100
Sukth	7.7	7.2	6.8	6.8	8.7	12.0	19.0	18.4	15.4	11.1	7.3	7.2	127.6

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

Vlera mesatare e diteve me re

Stacioni I monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	12.3	12.6	12.2	11.7	7.2	4.3	1.2	1.8	3.6	7.2	11.9	12.7	98.7
Kamez	12.4	10.9	10.3	9.9	6.1	3.9	0.8	1.4	2.3	6.3	11.0	11.6	86.9
Sukth	10.	10.2	9.2	7.6	4.6	3.3	0.7	1.3	2.9	5.0	9.7	10.6	75.1

Vlera mesatare e rrezatimit

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	142.9	208.3	300	358.1	476.8	549.1	570	511	398.7	270	172.5	135.6	4093

Era

Ndikimi i detit Adriatik ne rajonin Tirane-Durres eshte I dukshem sidomos per sa I perket shpejtesise se eres dhe rregjimit te saj karakteristik gjate stines se veres. Ererat jane nje element mjaft I rendesishem per gjeografine dhe agro-metereologjine e rajonit. Kjo lidhet jo vetem me qarkullimin e pergjithshem te atmosferes por dhe me relievin dhe afersine e detit. Era ka karakterin e puhizes detare vecanerisht gjate sezonit te nxehte, dmth gjate dites era fryn nga deti ne toke, ndersa gjate nates nga toka ne drejtim te kundert. Drejtimi mbizoterues I eres ndryshon sipas stineve. Gjate periudhes se veres era dominuese fryn nga kuadranti I perendimit, nersa gjate periudhes se dimrit era fryn nga kuadranti I lindjes.

Intensiteti i eres sipas drejtimeve

Nr.	Elementet	Nr. Era	Drejtimi i eres							
			V	VL	L	JL	J	JP	P	VP
1.	Shperndarja vjetore e drejtimit 35ndustr (%)	11.9	27.5	2.9	4.3	16.7	8.2	4.7	12.5	8.1
2.	Shpejtesia mesatare(m/s)	–	3.3	2.4	3.5	4.5	6.7	5.8	4.9	4.4

Sic shihet periudhat pa ere perfaqesojne 11.9% te rasteve te pergjithshme te drejtimit. Duke iu referuar tabelës dhe trendafilit verëjme që drejtimi verior, N është mbizoteruesi me 27.5%, kurse vlerat minimale të rasteve janë sipas drejtimit verilindor NS me 2.9%. Mesatarja e shpejtesive sipas ketyre drejtimeve respektivisht janë: 3.3 dhe 2.4 m/s.

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

Mesatarja e shpejtesise se eres sipas stineve

Nr.	Stinet	Shpejtesi m/s
1.	Dimer (XII-I)	4.9
2.	Pranvere (III-V)	4.4
3.	Vere (VI-VIII)	3.9
4.	Vjeshte (IX-XII)	4.3
5.	Vjetore (I-XII)	4.4

Duke iu referuar tabelës së mësipërme shpejtësia mesatare në stinën e dimrit është 4.9 m/s, ndërsa mesatarja vjetore 4.4 m/s.

Era e forta që fryjë sipas drejtimeve veri, N e juglindje SE me shpejtësi 40-45 m/s kanë në përgjithësi kohezgjatje të kufizuar, kështu që ndikimi i tyre në rregjimin e valesimit është i vogël. Era me shpejtësi 10-20 m/s jo vetëm kanë rastisje me të madhe por kanë dhe drejtim me të qendrueshëm. Në këto kushte shpejtësia e erës 20 m/s është për zgjedhur si shpejtësi për vlerësimin e valesave maksimale llogaritesë për qëllime projektimi.

Tokat e zones

Perdorimi i tokës

Tokat bujqësore në rajonin e Tiranës, kanë pësuar transformime të konsiderueshme në harkun kohor të njëzet viteve të fundit, si pasojë e aktivitetit njëzëz të pakontrolluar.

Dëmtimi i zinxhirit të prodhimit bujqësor në rajon ka prekur të gjithë elementet përberës të tij duke ndërvepruar direkt mbi mjedisin në teresi si dhe mbi jetën njëzëzore.

Politikat territoriale të deritanishme nuk mundën të ruanin një zhvillim të qendrueshëm në Sistemin e Urbanizimit Urban – Rural, si pasojë e kërkesës për zhvillim në hapsira shërbimi dhe banimi, formale dhe informale.


Sistemi i vaditjes së tokave bujqësore dhe sistemi i rezervuarëve të rajonit si dhe nderlidhja e tyre me rrjetin e burimeve ujore janë dëmtuar rëndë nga mungesa e mirmbajtjes si dhe nga dëmtimet njëzëzore.

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

Sistemi i magazinimit perpunimit dhe nderlidhjes se tregjeve rajonale eshte inekzistent si pasoj e zhvillimit te pakontrolluar dhe ndryshimit te destinacionit te perdorimit te godinave pas privatizimit te tyre ne vitet 1990.

Siperfaqet e tokave bujqesore ne rajon u demtuan rende nga ndertimet formale dhe informale, duke ndryshuar eficencen e tyre ne shfrytezim dhe perdorim si dhe duke ndryshuar statusin e perdorimit te tokes.

Zona ne studim perfshihet ne zonat e banuara para viteve '90.



Harta e perdorimit te tokes

(toka bujqesore, zona te populluara para 1990, zona te populluara pas 1990)

Rajoni ka nje numer te konsiderueshem tokash bujqesore te cilat jane me produktivitet te larte por me eficence perdorimi te ulet.

Pershkrimi gjeomorfologjik dhe peizazhi

Relievi i Shqiperise eshte kryesisht malor. Vargmalet e para alpine u formuan nga mbarimi i jurasikut, ndersa gjate eres kenozoike u shpejtua procesi malformues ne

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

teresine e Albanideve, qe tani perbejne token e nentoken e Shqiperise. Lartesia mesatare e relievit eshte 708 metra, ose 2 here me e larte se mesatarja e Evropes. Lartesite me te medha gjenden ne Alpet shqiptare dhe ne malet e Lindjes (Korabi 2751 metra mbi nivelin e detit, perben edhe majen me te larte te Shqiperise).

Territori i Shqiperise ndahet ne 4 regjione te medha natyrore (fiziko-geografike):

- Rajoni Verior dhe Verilindor
- Rajoni i malore qendrore
- Rajoni i maleve jugore
- Ultesira perendimore

Fushat zene kryesisht pjesen perendimore, pergjate bregdetit Adriatik, por ka edhe ne pjese te tjera te vendit. Fushat me te larta jane ato te pellgut te Korces, mbi 800 metra mbi nivelin e detit. Fushat gjenden kryesisht pergjate lumenjve kryesore si: Vjose, Devoll, Osum, Shkumbin, Erzen, Mat e Drin, ku gjenden, gjithashtu, edhe tokat bujqesore e qendra te medha banimi, si dhe pershkohen nga rruge te rendesishme lidhjesh.

Nga Krahina Malore Veriore vlen te vecohen Alpet Shqiptare qe shquhen per kontrast te madh midis maleve te larta dhe luginave te thella. Rreth 30 maja malesh ndodhen mbi 2 500 m mbi nivelin e detit. Nder luginat dallohen sidomos lugina e Valbones dhe ajo e Thethit. Krahina Malore Qendrore nuk eshte aq kompakte sa ajo veriore, por e ndare ne disa masive malore, si: Vargu i Korabit, Malet e Lures, Malet e Skenderbeut etj. Keto male nderpriten nga lugina te ndryshme. Krahina Malore Jugore arrin deri ne detin Jon ne jug dhe eshte e copetuar ne disa vargje malore dhe lugina lumore. Vend te vecante ne te ze riviera shqiptare, e cila shtrihet nga Gjiri i Vlores deri ne Butrint ne jug. Pergjate bregdetit Adriatik, ne perendim te vendit shtrihet Ultesira Perendimore e Shqiperise me gjatesi nga veriu ne jug rreth 200 km dhe me gjeresi nga perendimi ne lindje, deri ne 50 km. Kjo ultesire perben ultesiren me te madhe ne pjesen perendimore te Ballkanit dhe eshte rajoni me i zhvilluar ekonomik i Shqiperise.

Relievi i tokave shqiptare shtrihet nga niveli i detit deri ne lartesine 2751m (mali i Korabit). I gjithe ky ndryshim i lartesis ndikon ne ndryshimet e medha klimaterike, ne bimesi, si dhe ne dendesine e vendosjes se qendrave te banuara ne drejtim vertikal. Ne relievin e tyre mbizoterojne kodrat dhe malet. Duke u nisur nga lartesia mbi nivelin e detit, dallohen: relievi i ulet, i mesem dhe i larte. Relievi i ulet shtrihet nga niveli i detit, deri ne 200 m mbi kete nivel. Ai perfshin fushat dhe kodrat e uleta prane brigjeve detare te Adriatikut e Jonit dhe pergjate sektoreve te mesem te luginave lumore. Relievi i mesem shtrihet nga 200 deri ne 1000m mbi nivelin e detit. Ai ka shtrirjen me te madhe dhe perfshin: kodrat, gropat, fushegropat dhe luginat kryesore.

Raport paraprak VNM, “Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”- “Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.

Relievi i larte shtrihet 1000 m mbi nivelin e detit dhe perfshin malet dhe sistemet malore. Pjesa me e madhe e ketyre maleve ka lartesi deri ne 2000 m. Malet me lartesi me te madhe se 2000 m kane shtrirje te kufizuar.

Sizmiciteti

Ne vendin tone jane percaktuar zonat e burimeve sizmike jane terrene qe kane nje aktivitet sizmik te dallueshem. Shqiperia eshte nje nder vendet me sizmioaktive ne Evrope. Sizmiciteti i Shqiperise karakterizohet nga nje mikroaktivitet sizmik intensiv ($1.0 < M < 3.0$), nga shume termete te vegjel ($3.0 < M < 5.0$), nga termete te rralle me madhesi mesatare ($5.0 < M < 7$) dhe shume rralle nga termete te forte ($M > 7.0$). Shumica e termeteve te forte ndodhin ne 3 breza sizmike mire te percaktuar, si vijon:

- Brezi termetor Joniko-Adriatik, ne buzen lindore te mikroplakes se Adrias me shtrirje veriperendim – juglindje
- Brezi termetor Peshkopi – Korce, me shtrirje veri-jug,
- Brezi termetor Elbasan – Diber, me shtrirje verilindore.

Harta e meposhtme percakton zonat me rrezik sizmik me te larte, ku kane ndodhur edhe termetet me te medha ne rajon. Zonat me te rrezikuara per nga veprimtaria e termeteve jane Durresi, Vlora, Saranda, Lezha, Shkodra, Korca Kukesi, Dibra, Lushnja etj. Qytetet si; Durresi, Vlora, Shkodra, Pogradeci, Korca, Elbasani, Peshkopia, etj., jane goditur nga termete te fuqishme ne shekullin e XX.




Fig. Harta e rrezikut sizmik dhe Qarqet kryesore sizmike

4. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TE MUNDSHME, NEGATIVE, NE MJEDIS, TE PROJEKTIT

Metodika e identifikimit te ndikimeve te mundshme ne mjedis

Cdo veprimtari e re qe zhvillohet ne mjedis shoqerohet me pasoja dhe ndikime qe jane pjese e kompromisit qe shoqeria jone ka zgjedhur per t'u zhvilluar. Vleresimi i ndikimeve te mundshme ne mjedis si pasoje e zbatimit te projektit te propozuar eshte bere gjykuar mbi faktoret qe lidhen me natyren e veprimtarise, nen kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedis eshte analizuar sipas fazave te veprimtarise si me poshte:

- Ne fazen perгатitore/ ndertimit/rikualifikimit te bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”- “Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane,
- Ne fazen e funksionimit te bllokut te rrugeve.

Cdo faze e zbatimit te projektit pervec ndikimeve te pergjithshme dhe te perbashketa ka edhe ato specifike qe varen nga faktoret qe i shkaktojne si p.sh. natyra e proceseve etj.

Eshte e rendesishme te kuptohet natyra e ketyre proceseve dhe forma e shfaqjes se tyre, direkte dhe indirekte, per te vleresuar drejt ndikimet e cdo veprimtarie qe perdor burimet natyrore. Sipas natyres ndikimet klasifikohen ne dy grupe te medha:

- Ndikime te kthyeshme,
- Ndikime te pakthyeshme.

Te dy llojet e ndikimeve mund te minimizohen ne terma relative ku qellimi kryesor eshte mbajtja e ndikimit brenda siperfaqes se cdo objekti dhe krijimi i kushteve natyrore per te siguruar riaktivizim te proceseve komplekse te natyres dhe rigjenerim te biodiversitetit.

Vete natyra e aktivitetit te propozuar dikton ndikime dhe efekte te perhershme ose ndikime mbetese ne karakterin e mjedisit te sapokrijuar pergjate gjithë teresise se tij, per zbutjen e te cilave propozohen masa konkrete.

Ne paragrafet qe vijojne do te perpiqemi te identifikojme ndikimet e mundshme qe do te kete ne mjedis veprimtaria e ardhshme e rikualifikimit te rrugeve. Kete identifikim

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

do ta bejme sipas elementeve te vecante te mjedisit: ne ujrat siperfaqesore, ne ujerat nentokesore dhe ne toke e ne shkembinjte e zones se veprimtarise e perreth saj.

Ndikimi ne ujerat siperfaqesore

Nga veprimtaria e punimeve, si germime etj, si dhe e transportit, eshte e kuptueshme qe do te shtohet sasia e materialit pluhuror dhe kokrrizor. Gjate reshjeve te shiut nje pjese e ketij materiali, si edhe e tokes se shkrifet ka per t'u shpelare dhe permes rrjedhave te perkohshme do te kaloje ne perrenjte e zones perreth duke rritur permbajtjen e lendeve pezull te ujerave te tyre. Megjithate, meqenese zona nuk ka rrjedhje te perhershme ujerash siperfaqesore, ndikimi do te jete i kufizuar. Nje pjese tjeter e ketyre materialeve do te transportohet nepermjet sistemit te varjeve me anen e ujit te infiltrimit ne thellesi te shkembinjve gelqerore.

Ndikimi ne ujerat nentokesore

Per sa i perket ndotjes se ujrave nentokesore, mund te permendim te njejtat argumente si per ujerat siperfaqesore. Mosperdorimi ne pergjithesi i lendeve helmuese ose ndotese gjate implementimit te projektit eshte faktor pozitiv, meqenese nuk krijohen premisa per ndotjen e ujerave nentokesore.

Ne tabelen me poshte jepen ndikimet e mundshme ne ujerat nentokesore nga faktore te ndryshem, ne faza te ndryshme te projektit.

Ndikimet e mundshme ne ujerat nentokesore

Faktori i ndikimit	Fazat e veprimtarise se projektit		
	Para ndertimit	Gjate ndertimit	Gjate shfrytezimit
Kimikate	o	o	o
Lende helmuese	o	o	o
Hidrokarbure	o	o	o
Lende organike	-	-	o
Turbullira	o	-	+

Shpjegues per shenjat e tabelës:

Nuk ka ndikim o

Ndikim negativ -

Ndikim pozitiv +

Ndikimi ne toke/shkemb

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

Nisur nga nivelet e punimeve parashikohet te mos kete ndikime te aspekteve te erozionit, duke qene se objekti do te ndertohet ne nje zone urbane, ku jane te pranishme objekte ekzistuese dhe objekte banimi.

Nuk do te kete largim te shtreses bimore qe te mund te ndikojne ne erozion. Era ka per te larguar materialin e imet qe mund te mbetet pas heqjes se tokes ose qe do te grumbullohet ne sektore te ndryshem.

Ndikimet nga zhurmat

Zhurmat do te shkaktohen nga levizja e mjeteve e kryesisht nga perdorimet e mundshme te makinerive te renda qe do te perdoren germime dhe me pas per shtrimin e rrugeve (sipas shtresave). Ndikimi i zhurmave ne faunen e zones mendohet qe nuk do te jete potencial, pasi zona nuk ka faune duke qene nje zone e urbanizuar.

Kjo matrice eshte hartuar mbi bazen e seleksionimit te ndikimeve me te rendesishme duke patur parasysh gjendjen e mjedisit perpara fillimit te implementimit te objektit (bllokut te rrugeve), ndikimet gjate shfrytezimit dhe gjendjen pas zbatimit te masave zbutese/rehabilituese. Ne vleresimin e ndikimeve ne mjedis, gjendja para fillimit te shfrytezimit te bllokut te rrugeve eshte marre si reference krahasuese me periudhen e shfrytezimit te objektit dhe ate pas masave zbutese/rehabilituese.

Tabela. Matrica permbledhese e ndikimeve ne mjedis

	Para projektit	Gjate shfrytezimit	Pas rehabilitimit
Ujerat siperfaqesore	o	o --	+
Ujerat nentokesore	o	o --	o +
Erozioni	o	--	+
Flora	o	--	+
Fauna	o	--	+
Ajer	o	--	+

- "o" nuk ka ndikim
- " -- " ndikime negative
- " + " ndikim pozitiv

Edhe ne aspektin shoqeror-ekonomik, shfrytezimi i objektit, do sjelle impakte pozitive te cilat lidhen me permiresimin e infrastruktures se zones, e cila ashtu sikurse ilustruhet dhe nga fotot e gjendjes ekzistuese nuk eshte plotesisht funksionale apo ne gjendje te mire.

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

5. PERSHKRIMI PER SHKARKIMET E MUNDSHME NE MJEDIS

Gjate fazes se ndertimit do te kemi ndikime ne toke te cilat do te konsistojne ne:

- Perdorimin e tokes
- Ne cilesine dhe sasine e tokes
- Struktura gjeologjike

Keto ndikime nxiten nga punimet qe do te kryhen per rikualifikimin e bllokut te rrugeve dhe nuk pritet te kete ndryshime ne topografine lokale.

Zbatimi i projektit nuk do te ndikojte negativisht ne ujerat siperfaqesore pasi nuk do te krijohen basene per rregullimin e regjimit te prurjes se burimit.

Ndikimet ne cilesine e ajrit llogariten me te larta gjate fazes se punimeve per pergatitjen e terrenit per shtrimin e rrugeve dhe rikualifikimin e tyre.

Emetimet do te vijne nga punimet:

- *Germimet/ nivelimet e shtreses se cakellit,*
- *Transporti i materialeve per shtrimin e rrugeve.*

Gjithsesi keto ndikime jane te pakonsiderueshme

Ne kete veprimtari nuk do te perdoren lende kimike te cilet mund te jene ndotes per mjedisin ne kete aktivitet nuk do te kete shkarkim te ujrave teknologjik per pasoje gjate ushtrimit te aktivitetit nuk ka emetime te aromave sulmuese te cdo lloj qofshin ato.

Gjate fazes se ndertimit:

Ndikime ne toke- Gjate kesaj faze do te kemi ndikime ne toke te cilat do te konsistojne ne:

- Perdorimin e tokes
- Ne cilesine dhe sasine e tokes
- Struktura gjeologjike

Keto ndikime nxiten nga punimet qe do te kryhen per rikualifikimin e rrugeve dhe nuk pritet te kete ndryshime ne topografine lokale.

Por duhet te theksojme se zona ne te cilen do te punohet per rikualifikimin e bllokut te rrugeve kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”- “Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane nuk ka ndikim ne sasine dhe cilesine e tokes are.

Raport paraprak VNM, “Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”- “Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.

Ne pikepamje te struktures gjeologjike dhe pamjes se reljevit, kjo zone nuk ka vecori tipike dalluese dhe nuk ka asnje arsye te vleresohet ose te merret parasyshe gjate ketij aktiviteti. Kjo zone perben nje peisazh te zakonshem gjeologjiko - gjeomorfollogjik, karakteristike e ketij rajoni. Keto punime nuk kane asnje ndikim ne cilesine e tokes. Ndikimet e projektit ne modelin drenazhues te zones: Projekti i parashikuar nuk ndikon ne modelin e drenazhimit se nuk ekzistojne vepra drenazhimi ne zonen e projektuar perreth zones.

Ndikime ne uje

Ky eshte nje aktivitet i cili ka si nje nder elementet kryesore ka ujin per lagien e kantierit gjate ndertimit keshtu qe ndikim verehet ne sasine e perdorimit te ujit gjate fazes se funksionimit si rruge.

Por sasia e marrjes se ujit ne keta burime per komunitetin, pasi eshte matur prurja per cdo muaj dhe per 12 muajt e vitit. Ne cdo kohe do te plotesohen nevojat e komunitetit per perdorim pirje dhe per cdo aktivitet tjeter qe kerkon perdorim te ujit.

Zbatimi i projektit nuk do te ndikojte negativisht ne ujerat siperfaqesore pasi nuk do te krijohen basene per rregullimin e regjimit te prurjes se burimit.

Nga ky aktivitet nuk do te kete demtime te trupave ujore dhe rrjedhimisht, as masa mbrojtese.

Ndikime ne ajer

Ne cilesine e ajrit llogariten me te larta gjate fazes se punimeve per rikualifikimin e bllokut te rrugeve.

Emetimet do te vijne nga punimet:

- *Germimet/ nivelimet e shtreses se cakellit,*
- *Transporti i materialeve per shtrimin e rrugeve.*

Gjithsesi keto ndikime jane te pakonsiderueshme

Kryedisht emetimet qe do te gjenerohen do te jene pluhra te cilat do te jene ne nivel me te larte ne ditet me ere dhe diell te forte. Por ky ndikim nuk llogaritet te kaloje vlerat e lejuara.

Emetimet qe vine nga mjete motorike, si *Kamionet*.

Gjate fazes se funksionimit:

Ndikimet ne toke

Gjate fazes se funksionimit nuk priten ndikime ne toke pasi nuk do te kryhen punime shtese. Ne perfundim te fzes se ndertimit kompania zhvilluese e projektit do te marre te gjitha masat per rehabilitimin e zones per te eliminuar cdo ndikim gjate kesaj faze.

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

Ndikimet ne uje-

Gjate ushtrimit te ketij aktiviteti nuk do te kete ndikime ne cilesine e ujit pasi do te kryhet lidhja me rrejtin ekzistuese te Ujesjelles Kanalizime Tirane.

Ndikimet ne ajer

Ne kete veprimtari (shtrimin e rrugeve) nuk do te perdoren lende kimike te cilet mund te jene ndotes per mjedisin ne kete aktivitet nuk do te kete shkarkim te ujrave teknologjik per pasoje gjate ushtrimit te aktivitetit nuk ka emetime te aromave sulmuese te cdo lloj qofshin ato.

Pra ndikimit jane te paperfillshme, madje ndikimet ne ajer nga ky projekt do te jene pozitive. Pra ky projekt do te sjelle permiresime ne cilesine e ajrit ne kete zone, duke qene se do te permiresohet infrastruktura dhe nuk do te ngrihet pluhur nga automjetet gjate diteve me diell.

Nga mjete motorike te permendura me lart do te kemi emetime te gazeve CO₂, SO₂, PM 10 dhe PM 2.5 etj. Ky ndikim nuk eshte i larte pasi automjete do te perdorin karburant cilesore dhe do te jene ene gjendje shume te mire mekanike.

Pra nga sa me siper verehet qe ndikimet e projektit ne mjedis do te jene vetem gjate fazes se ndertimit, ndersa gjate fazes se funksionimit keto ndikime do te jene te pa konsiderueshme per te mos thene qe nuk do kete fare ndikime.

6. TE DHENA PER SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPESINORE TE NDIKIMIT NEGATIV NE MJEDIS

Ky projekt nuk ka dhe nuk do te kete ndikime negative ne shtrirje hapsinore, madje dhe ne zonen ku do te zhvillohet projekti keto ndikime do te jene te pakonsiderueshme dhe vetem gjate rikualifikimit te bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”- “Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

7. MASAT E MUNDSHME PER SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS;

Programi i menaxhimit

Plani i menaxhimit te mjedisit

Cdo veprimtari e rendesishme qe kryhet ne marredhenie me mjedisin, duhet te parashikoje ne projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit te Mjedisit (PMM), qellimi i te cilit eshte parandalimi, minimizimi dhe menjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit te veprimtarise qe propozohet te kryhet.

Qellimi kryesore i PMM eshte te siguroje nje proces te drejte gjate projektimit, ndertimit dhe operimit ne terma te impaktit dhe masave parandaluese.

- **Faza e projektimit**

Gjate kesaj faze eshte e rendesishme grupi i inxhinierëve ka kryer inspektime te vazhdueshme ne zone per te vleresuar elementet kryesore te zones per te evituar ne maksimum prishjen e ekuilibrit natyror nga zhvillimi i kesaj veprimtarie.

- **Faza e ndertimit/ rikualifikimit te bllokut te rrugeve**

Punimet e rikualifikimit te bllokut te rrugeve kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”- “Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane do te mbikqyren nga persona te specializuar. Duhet te zbatohen te gjitha planet e punes per intervalin e punimeve. Te zbatohen menytrat e zgjedhura nga kompania per menaxhimin e mbetjeve.

Gjate operacioneve te ndertimit do te gjenerohet nje sasi e jo shume e madhe dherash dhe mase shkembore. Kjo sasi dheu klasifikohet si mbetje ndertimore nese lind nevoja te depozitohet apo zhvendoset nga zona ne nje siperfaqe tjeter. Shoqeria qe do te zbatoje projektin duhet te planifikoje qarte menyren e administrimit te dherave per te menjanuar mundesine e depozitimit te tyre pergjate brigjeve te lumit dhe perrenjeve. Nje pjese e kesaj mase dheu mund te perdoret gjate ndertimit te veprave inxhinierike dhe sistemimit te rrugeve e shesheve te sherbimit, ndersa pjesa tjeter do te depozitohet ne vende te caktuara per kete qellim duke ndjekur dhe kuadrin ligjor ne fuqi.

- **Faza e operimit**

Ne perfundim te fazes se ndertimit te meren masa per rehabilitimin e zones se prekur nga implementimi i projektit. Gjate funksionimit te shkolles do te te ndiqen politika

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

rehabilituese dhe permiresuese te mjedisit, me qellim dhe edukimin e brezave te ardhshem.

Kualifikimi i personelit dhe masat mbrojtese te pergjitheshme

Eshte nje nga planet me me rendesi te Planit te Menaxhimit te Mjedisit, ndonese lidhet ne menyre jo te drejtperdrejte me mjedisin apo ndikimin ne te. Ne bashkerendim te plote me Kontraktorin e ndertimit, do te hartohet nje plan i kualifikimit te gjithe personelit qe do te impenjohet ne sheshin e projektit gjate kohes se zbatimit te projektit te rehabilitimit te sheshit dhe venies ne shfrytezim. Trajnimi do te mbuloje kushtet ekzistuese te mjedisit, ndikimet potenciale ne mjedis nga projekti i ndertimit, implementimin e masave lehtesuese specifike ne minimizimin ose eliminimin e ndikimeve negative, dhe masat e pergjithshme mbrojtese per mjedisin.

Programi i monitorimit

Ne VKM per programin e monitorimit ne RSH jepet qarte indikatorët mjedisore qe monitorohen megjithate keta indikatorë duhet te pershtaten dhe t'i perkasin veprimtarise. Qellimi i monitorimit mjedisor per kete veprimtari eshte qe te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet nese operimi i veprimtarise eshte ne perputhje me ligjet dhe standartet mjedisore qe lidhen me te si dhe per te vleresuar performance mjedisore te menaxhimit te saj ne kuader te permiresimit te vazhdueshem i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokes, derdhjeve urbane etj, kryhet sipas disa kriterëve shkencore persa i perket vrojtimeve, mbledhjes dhe analizave te mostrave. Ai synon ne mbledhjen e te dhenave per te vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror ne ndryshimet e mjedisit, ku ai eshte aktiv. Programi I monitorimit do te perdoret per te verifikuar qe te gjitha ndikimet e mundeshme qe do ti vijne mjedisit nga ndertimi dhe operimi i punishtes se ujit, jane marre parasyshe.

Programi i monitorimit per sejcilen ndotje potencjale qe mund ti shkaktohet Mjedisit eshte dhene me poshte dhe duhet te mbikqyret nga ARM-ja.

Objektivat kryesore te monitorimit

Programi i monitorimit do te perdoret per te verifikuar qe te gjitha ndikimet e mundeshme qe do ti vijne mjedisit nga rikualifikimi dhe funksionimi i rrugeve kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”- “Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane, jane marre parasyshe. Programi i monitorimit per secilen ndotje potenciale qe mund ti shkaktohet mjedisit eshte dhene me poshte dhe duhet te mbikeqyret nga ARM-ja.

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

Objektivat kryesore te monitorimit jane:

- Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktesisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit te burimeve.
- Per te siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) te burimeve dhe shkaqeve te tyre.
- Per te evidentuar cilesine e mjedisve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor, me synim per te marre masat e nevojshme per permiresimin e tyre.
- Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore.

Investitori do te monitoroje vetem pikat per te cilat ai ndikon mbi to (pikat do te percaktohen nga organet kompetente), si dhe i dergojne keto te dhena ne Agjencine Rajonale te Mjedisit.

Keto te dhena do te vihen ne dispozicion te inspektoreve te mjedisit gjate inspektimit te tyre ku nga ana e firmave kontraktuese do te kete gjithmone bashkepunim. Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjitha treguesve te percaktuar.

Regjistrimi i te dhenave mjedisore

Per te ruajtur te dhenat mjedisore te veprimtarise do te pergatitet dhe mbahet nje regjister i vecante ku do te hidhen vazhdueshmerisht te dhenat mjedisore.

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

**8. NDIKIMET E MUNDSHME NE MJEDISIN
NDERKUFITAR (NESE PROJEKTI KA NATYRE TE
TILLE).**

Konventa “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis ne kontekst nderkufitar (Konventa ESPOO)” ka per qellim vleresimin e ndikimit ne mjedis te projekteve qe zhvillohen kryesisht ne zona nderkufitare dhe qe mendohet qe mund te kene ndikim ne mjedisin e vendeve fqinje. Shqiperia eshte pale ne kete Konvente qe prej 4 Tetorit te vitit 1991. Kjo Konvente synon bashkepunimin midis shteteve per mbrojtjen e mjedisit nderkufitar nga projektet me ndikim ne mjedis nepermjet:

- Njoftimit paraprak te shtetit, mjedisi i te cilit mund te ndikohet nga nje projekt i caktuar. Njoftimi behet nga Shteti, i cili synon te zbatoje projektin ne territorin e tij, i cili e fton Shtetin qe mund te ndikohet te marre pjese ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis te projektit te propozuar, duke i dhene kohe te mjaftueshme dhe vene ne disponim raportin e vleresimit te ndikimit ne mjedis te projektit te propozuar;
- Duke e njoftuar Shtetin e ndikuar per vendimin perfundimtar per projektin dhe kushtet per mbrojtjen e mjedisit qe duhet te respektohen.

Gjthashtu nga Shqiperia jane ratifikuar edhe amendamentet e saj, vendimet II/14 dhe III/17, nepermjet Ligjit Nr. 9478, date 16.02.2006 "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne vendimet II/14 dhe III/17, Amendamentet e Konventes se ESPOO-s "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis, ne kontekst nderkufitar".

Subjekt i kesaj konvente jane te gjitha projektet e listuara ne shtojcen I te kesaj Konvente, ose me sakte ne Amnedamentin e dyte te kesaj Konvente, ku jane listuar te gjitha projektet qe i nenshtrohen kerkesave te kesaj konvente.

Projekti i propozuar nuk ben pjese ne shtojcen 1 te kesaj konvente dhe mbi te gjitha nuk do te ushtrohet ne nje territor kufitar.

**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

9. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

Perfundime

Nga sa eshte konstatuar dhe verifikuar ne vend dhe qe pasqyrohet ne kete raport te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis te veprimtarise se mesiperme rezulton se ushtrimi i ketij aktivitetit per rikualifikimin e bllokut te rrugeve kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”- “Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane, behet konform te gjitha rregullave dhe standarteve te ndertimit ne kuader te mbrojtjes se mjedisit.

Persa i takon ndikimit ne mjedis ai eshte parashikuar dhe vleresuar me nje objektivizem. Ne materialin e mesiperme shihet qarte se ky eshte nje ndikim minimal dhe pothuajse i paperfillshem por gjithsesi subjekti eshte i ndergjegjshem se sado minimal ky ndikim duhet te mire-menaxhohet dhe te behen prepjekje teknike per te bere kete ndikim me vlere zero.

Rekomandime

- I. Zhurmat ne ambjentet e punes te mbahen nen kontroll per te mos patur ndikime negative ne ambjentet perreth.
- II. Mbetjet inerte qe nuk mund te riperdoren per punime sistemimi brenda kantierit te depozitohen ne pikat e caktuara nga Bashkia dhe te ndiqen kerkesat e VKM nr. 575/2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte” dhe te gjithe legjislacionit kuader ne fuqi per menaxhimin e integruar te mbetjeve.
- III. Te ndertohet sistemi i drenazhimit dhe levizjes se ujerave te shiut, etj.
- IV. Te kontrollohen kushtet teknike te mjeteve te punes per ndertim ne menyre periodike per te evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve e te hidrokarbureve ne mjedis, emetimin e gazeve e zhurmave te teperta te shkaktuara nga avari teknike te mjeteve te subjektit.
- V. Te merren masa per te parandaluar reniet e zjarrit dhe te sigurohen mjetet e nevojshme te nderhyrjes e rast te renies se zjarrit (depozite uji, zjarrfrkse te levizshme, etj);
- VI. Subjekti zhvillues i punimeve te realizoje menjehere cdo nderhyrje per pastrimin e mjedisit ne ndonje rast derdhje lendesh ndotese ne mjedis.


**Raport paraprak VNM,
“Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruget “Marie Kraja”- “Kokonozet”-
“Zana Floqi”- “Filip Shiroka”, Tirane.**

Gjithashtu subjekti eshte i hapur t'i nenshtrohet cdo lloj auditimi dhe monitorimi nga institucione te administrimit dhe mbrojtjes se mjedisit perfshi dhe NGO si dhe trupa shkencore.

Hartoi Raportin e VNM

Emanuela ARIFI

Ekspert i VNM dhe Auditimit Mjedisor



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 5146 Prot.

Tiranë, më 22.6 2017

Nr. identifikues 353

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Znj. EMANUELA ARIFI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI


Lefter KOKA





REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES



LICENCË

Numri serial: LN-3547-07-2017

NUIS/NIPT: L71814020N

Subjekti: ENVIRONMENTAL AND SUSTAINABLE DEVELOPMENT OFFICE

Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Njesia Administrative Nr.8, Rruga "Ali Pashe Guca", Pallati 7 katesh, Shkalla 1, Ap.2

Kodi: III.2.A (1+2)

Kod tjetër:

Data e lëshimit: 19/07/2017

Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor dhe Vlerësimi i ndikimit në mjedis).

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nënshkrimi i sportelit:

